



BIRN
Blerta IBËRDEMAJ
Përfaqësuese ligjore e BIRN
Prishtinë

Ankesa Nr. 2019/84 BIRN vs RTK 1
Ref:1911/1294/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2019/84– BIRN (Palë Ankuese) kundër RTK 1

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, përmes të cilit përcaktohet sjellja e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin e VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje dhe Kodin e Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës si dhe Rregulloren për Komunikimet Komerciale audiovizuale KPM 2017/07.
2. KPM-së me datën 14 tetor 2019, ka pranuar një ankesë përcjellëse nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), të cilën e ankesë e ka parashtrur në PZAP me datë 5 tetor 2019 Pala Ankuese, lidhur me transmetimin e hapësirës së sponsorizuar nga subjekti politik LDK, të cilën RTK 1 e ka transmetuar pas mesnatës në ora 00:24:40 me datë 5 tetor 2019. Pas vlerësimit të ankesës PZAP ka vendosur që është kompetencë e KPM-së të merret me ankesën.
3. Sipas ankesës së Palës Ankuese pretendohet se: *OSHMA RTK 1 me 5 tetor 2019, ditën e heshtjes zgjedhore ka transmetuar hapësirë të sponsorizuar nga subjekti politik LDK, duke bërë shkelje të Ligjit për Zgjedhje e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, pasi që ndalohej çfarëdo fushate zgjedhore në ditën e heshtjes zgjedhore.*
4. KPM, me qëllim të vlerësimit të bazueshmërisë së ankesës, ka bërë monitorimin e programeve të transmetuara nga ana e OSHMA RTK 1. Në bazë të raportit të monitorimit të datës 15 tetor 2019, ka gjetur se RTK 1 me datë 5 tetor 2019, ka bërë transmetimin e kësaj hapësirë të sponsorizuar nga subjekti politik LDK (saktësisht në orën 00:24:40), mirëpo KPM ka konstatuar se OSHMA RTK 1 nuk ka bërë shkelje të Ligjit për Zgjedhjet

e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, konkretisht nenit 52 paragrafi 1, pasi që heshtja zgjedhore ka filluar në ora 7:00 të datës 5 tetor 2019.

Analiza Ligjore

5. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se OSHMA RTK 1, ndaj të cilit është parashtruar ankesë nga ana e Palës Ankuese nuk është gjetur në shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, pasi që transmetimi i hapësirës së sponsorizuar nga subjekti politik LDK është transmetuar kur akoma nuk ka filluar heshtja zgjedhore.

Neni 52, paragrafi 1, i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr 03/L-073 përcakton se:

“Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve.”

6. KPM bazuar në nenin 52 paragrafi 1 për të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr 03/L-073 ka konstatuar se RTK 1 nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi që heshtja zgjedhore ka filluar në ora 7:00 të datës 5 tetor 2019.
7. Komisioni i KPM-së konstaton se RTK 1 nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, pasi që transmetimi i hapësirës së sponsorizuar nga subjekti politik LDK për të cilën është parashtruar ankesë nga ana e Palës Ankuese është transmetuar para fillimit të heshtjes zgjedhore.

Vendim

8. REFUZOHET si e pabazuar Ankesa e BIRN përmes së cilës pretendohet se RTK 1 ka bërë shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr 03/L-073.

E drejta për Ankesë

9. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
10. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Muja FERATI
Kryetar



04. 11. 2019
Datë